



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **30 tetor 2014**, pas shqyrtimit të Draft-Statutit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Statuti për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 31 tetor 2014 dhe zgjatë deri më 18 nëntor 2014.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4

Obligohet Kryetari i Komisionit që si hartues dhe propozues i Draft-Statutit në fjalë për që si hartues dhe propozues i Propozim-vendimit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu Kryetari i komisionit obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Statutit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Nëntor 2014.


Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, si dhe nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 tetor 2014**, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01NR.24/14, DT. 30.01.2014

Neni 1

Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i KK-së 01Nr.24/14, dt. 30.01.2014, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si vijon: në nënparagrafin 1.1., nënpika 6 në vend të Tahir Maxhunit duhet të jetë **Berat Maloku**.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Shpëtim Zhegrova
Kryesuesi i Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	226/14
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	30. 10. 2014
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, nenin 6 të Rregullores 01Nr.186/13, dt.25.07.2013 për Dhënie e Dekoratave, si dhe Vendimin 01Nr.127/14, dt.28.05.2014 për Ndarje të Mirënjohjeve për Ditën e Çlirimit, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me **30 tetor 2014**, mori këtë:

V E N D I M PËR HARMONIZIMIN E LISTËS SË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Me këtë Vendim nga kategoria “subvencione” rubrika “kulturë” nga shuma e përgjithshme njëzetentë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë euro (29,375.00 €) merret (hiqet) shuma prej pesëmijë euro (5.000 €).

Neni 2

Shuma e përmendur në nenin 1 të këtij Vendimi ndahet për dhënie e të hollave nga njëmijë euro (1.000 €) me rastin e ndarjes së titullit “Nderi i Qytetit” për secilin nga këto raste:

1. Safet Ajeti;
2. Ilaz Kolla;
3. Aziz Bici;
4. Qazim Uka.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga kuvendi i komunës dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.


Shpëtim Zhegrova
Kryesuesi i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 “d” dhe nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 41.2 “ç” dhe nenin 55 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me **30 tetor 2014**, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01NR. 23/14, DT. 30.01.2014

Neni 1

Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 01Nr.23/14, dt.30.01.2014 për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete me sa vijon:
Emërohet anëtare e Komitetit për Komunitete Selvete Sholla në vend të Fatime Hazirit.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit

